



**REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO**  
**KOMUNA E GJAKOVËS**  
**OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA**

**Kryetarja e Komunës**

**01nr \_\_\_\_\_**

**Dt: 04.08.2015**

Kryetarja e Komunës së Gjakovës, në bazë të nenit 13 dhe 58 a dhe b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-04, Përfundimit 06-23138-6/1 të miratuar në mbledhjen e Bordit të Drejtoreve me date 25.03.2015 në të cilin është miratuar kërkesa e Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural për ndërtimin dhe funksionalizimin e Qendrës grumbulluese të qumështit në fshatin Lipovec si dhe në Përfundimin 06-40782-7/1 të miratuar në mbledhjen e Bordit të Drejtoreve me date 19.06.2015 në të cilin është miratuar kërkesa e Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural për menaxhimin e Qendrës grumbulluese të qumështit në fshatin Lipovec si dhe miratimi i tejkalimit të investimit të kësaj Qendre, me dt. 04.08.2015 e miraton këtë :

**V E N D I M**

1. Miratohet kërkesa e Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural për ndërtimin dhe funksionalizimin e Qendrës grumbulluese të qumështit në fshatin Lipovec. Ky investim do të kushtojë në vlerë prej 15,751.00€, vlera prej 15,000€ do të sigurohen nga linja e investimeve kapitale të DBPZHR-së ndërsa 751.00€ do të sigurohen nga linja për Bashkëfinancimit të Drejtorisë për Buxhet dhe Financa.
2. Autorizohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa që të realizojë procesin e zotimit të mjeteve financiare në vlerë prej 15,751.00€, vlera prej 15,000€ do të sigurohen nga linja e investimeve kapitale të DBPZHR-së ndërsa 751.00€ do të sigurohen nga linja për Bashkëfinancimit të Drejtorisë për Buxhet dhe Financa. Mjetet financiare në vlerë prej 15,751.00€ do të ndahen në dy pjesë, vlera prej 9,753.00€ do të barten në xhirollogarinë e NNPI "AreProject" shpk nr. 1402000001356286 në Bankën Ekonomike, ndërsa pjesa tjetër e mjeteve financiare në vlerë prej 5,998.00€ do të bartet në xhirollogarinë e NTP "Agroteknika" nr. 2025000075182197 TEB Bank.
3. Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural autorizohet që të nënshkruaj Memorandumin e Mirëkuptimit-bashkëpunimit me përfaqësuesin e bashkësisë lokale të fshatit Lipovec z. Isni Golaj për dhënien në menaxhim të qendrës grumbulluese të qumështit në fshatin Lipovec.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
4. Vendimi iu dërgohet:
  - Drejtorisë për Buxhet dhe Financa;
  - Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural
  - Arkivit

**Kryetarja e Komunës**

**Znj. Mimoza Kusari-Lila**

